




POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1500 efektive në terren për samitin e BE-së më 6 dhjetor, Tirana blindohet si për vizitën e Papa Françeskut



I bënte presion të martohej me një të moshuar, por ajo nuk planonte babai vret



'Ervis Martinaj është vrarë dhe i është zhdukur kufoma', xhaxhai i tij në 'Pe



Dua Lipa theu rekord botëror në koncertin madheshtor në Tiranë, tejkalon ikonën Tina




Aksident në Itali, 3 makina përplasen 'koka me koka' në Veronà Një 23-vjeçar

Kronikë

Në kërkim për atentatin ndaj dy vëllezërve Doçi në Shkodër, arrestohet 30 vjeçari në Tiranë! Kapet me pistoletë në makinë (VIDEO)

30-vjeçari, Besmir Përkola ishte shpallur në kërkim pasi ka qëlluar me armë zjarri, në drejtim të dy personave, në mars 2021, në Shkodër. Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë me municion luftarak dhe leja e drejtimit e dyshuar e falsifikuar! [Lidhje familjare e vëllezërve Doçi me 'trurin' e pengmarrjes së Jan Prengës në Kamëz](#)



Redaksia

29 Nëntor, 10:06 | Përditësimi: 29 Nëntor, 15:21



TIRANË- Besmir Përkola është arrestuar ditën e sotme nga policia e Tiranës pasi u kap me pistoletë në makinën dhe me leje drejtimi të falsifikuar. Mësohet se 30 vjeçari ishte shpallur në kërkim pasi ka qëlluar me armë zjarri ndaj dy vëllezërve Marjan dhe Hot Doçaj në **mars të vitit 2021** në Shkodër.

Policia ka sekuestruar armën e zjarrit pistoletë dhe municionin luftarak që Përkola e mbante në makinën me të cilën qarkullonte në Tiranë. Arrestimi i të riut është bërë nga forcat e posaçme “Shqiponja” në kuadër të operacionit të koduar “arratia”. Dy vëllezërit që mbetën të plagosur u transportuan për në spital dhe më pas u arrestuan për konfliktin me Besmir Përkolën.



LEXO EDHE:
FOTOLAJM/ Dua Lipa me pasaportë shqiptare, çmendet Instagrami bëjnë “like” 4.800.000 përdorues, dyfish nga zakonisht

Në mars të vitit 2021, policia arrestoi edhe dy vëllezërit Marjan dhe Hot Doçaj të cilët janë konfliktuar me Besmir Përkola. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur, u mësua mbiemri i familjes Doçi nuk ishte i panjohur për OFL-në pasi hetoheshin për lidhje me krimin e organizuar dhe për rrëmbimin e Jan Prengës nga Gentian Doçi, kushëriri i dy vëllezërve që u plagosën.

Kush janë vëllezërit Doçi, lidhja familjare me 'trurin' e pengmarrjes së Jan Prengës në Kamëz

Vëllezërit Hot dhe Marian Doçi, të cilët mbetën të plagosur me armë zjarri nga të shtënat e Besmir Përllokës, i përkisnin të njëjtës familje Doçi në Shkodër, e cila është e njohur edhe nga operacionet e OFL dhe mendohet se ka lidhje me krimin e organizuar. Një familje e lakuar edhe për rrëmbimin e Jan Prengës, pasi ato janë djem xhaxhai me **Gentian Doçin**, njëri nga personat e shpallur në kërkim për pengmarrjen dhe më pas zhdukjen e trupit të Jan Prengës në Kamëz, i cili rezultoi i shpallur në kërkim dhe nga autoritet italiane për trafik kokaine.

B.V/G.MO/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder, marian doc, gentian doc, Besmir perkola, Tirane, policia e tiranes

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

A është Shqipëria në rrugën e duhur pas 110 viteve pavarësi?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera



Zaloshnja: Vendlindja e prindërve të zgjedhësve në Bashkinë Tiranë dhe prirja e votimit



Eduard Zaloshnja

29 Nëntor, 16:23



Tiranë/ Goditi me thikë 35-vjeçarin gjatë një shërrë në Kombinat, arrestohet autori

29 Nëntor, 13:37



Denoncon Rithemelimi: Qindra banorë të Kamzës lihen në mëshirë të fatit! I drejtohen Berishës: Bashkia ka abuzuar me rindërtimin, po jetojmë në kushte skandaloze

29 Nëntor, 12:50



Përplasi për vdekje këmbësoren në Kombinat, arrestohet 38-vjeçari në Tiranë

29 Nëntor, 12:31



Kishin përshtatur lokalin për organizimin e lojërave të fatit në Shkodër, dy në pranga! Shpallet në kërkim pronari i lokalit (VIDEO)

29 Nëntor, 11:46



Shkodër/ Vendosija e yllit dhe nderim me grusht në 78 vjetorin e çlirimit të vendit, bashkia bojkoton ceremoninë

29 Nëntor, 10:49



Deda, 'Zelensky shqiptar' ironizon Bashën: Nuk shkoj në Bashki për ta mjelë si lopë e nesër të jem kreu i PD! Veliaj e ka luftën me Ramën


28 Nëntor, 22:49



Shkodër, ekspozitë me foto të rralla të Kolë Idromenos! I përfshirë edhe libri për jetën e punën e piktorit të shquar

Ergys Kavaja

28 Nëntor, 18:13



'Shqiptarët në Angli kriminelë?' Dua Lipa: Ne duhet ta ndryshojmë këtë stigmë! Kemi nevojë të pranohermi si rezidentë në çdo vend ku jetojmë

28 Nëntor, 16:17



'Grabisnin' të rinjtë që pinin hashash te kodrat e liqenit artificial, lihen në burg dy efektivet! Njëri prej tyre: Më kanë dhunuar në komisarjat

28 Nëntor, 11:14



Alibeaj 'sfidon' në Kamëz 2 ish-policët e Berishës dhe Rakip Sulin e Ramës në Kamëz! Kush është kandidati i Partisë Demokratike

28 Nëntor, 11:06



Digjet një makinë në Kamëz, përfshihen nga flakët edhe 2 të tjerë

28 Nëntor, 07:50